



Në bazë të nenit 6, paragrafit 6.5, të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës, Bordi i Federates së Tenisit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 17 Nëntor 2022 miratoi këtë:

RREGULLORE NR. #09

PËR

MASAT DISIPLINORE



PËRMBAJTJA:

1. Qëllimi.....	4
2. Përgjegjësitë.....	5
3. Anëtarët e bordit dhe stafi/komisionet/këshillet.....	8
4. Kodi I sjelljes për trajnerët	9
5. Kodi I sjelljes për sportistët.....	11
6. Kodi I sjelljes për gjyqtarët.....	12
7. Kodi I sjelljes për prindër.....	16
8. Kodi I sjelljes për udhëtime zyrtare.....	17
9. Dispozitat përfundimtare.....	18



FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION

Kosova Tennis Federation
House of sports
Agim Ramadani str,
10000 Prishtina
Kosovo
T: +383 45 746 543
www.tenniskosova.com

PËRKUFIZIMET

FTK	Federata e Tenisit e Kosovës
Bordi	Bordi Ekzekutiv i Federatës
ITF	Federata Ndërkombëtare e Tenisit



Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

- 1.1. Rregullorja për Masat Disiplinore të Federatës së Tenisit të Kosovës parasheh masat dhe përcakton procedurën e dënimit të lojtarëve, udhëheqësve teknik, udhëheqësve tjerë dhe gjithë pjesëmarrësve në gara dhe aktivitete tjera që bëjnë shkelje të Rregullores mbi organizimin e garave ose shkelin Rregullat e lojës, Statutin e FTK-së, Ligjin e sportit si aktet tjera normative të FTK-së.

Neni 2 Fushëveprimi

- 2.1. Ky Kod ka të bëjë dhe zbatohet :
- 2.1.1. Për të gjithë garuesit, pjesëmarrësit në gara;
 - 2.1.2. Për të gjitha ekipet, anëtarët dhe udhëheqësit e tyre gjatë gjithë kohës së zgjatjes së garave;
 - 2.1.3. Për të gjithë punëtorët sportiv të cilët punojnë në organizimin dhe realizimin e programeve sportive, gjyqtarët, personat zyrtarë dhe pjesëmarrësit tjerë në të gjitha nivelet.

Neni 3 Vlerësimi i rrethanave

- 3.1. Para shqiptimit të dënimit për kundërvajtje merret në konsiderim, veçanërisht:
- 3.1.1. Pësia e shkeljes dhe pasojat e saj;
 - 3.1.2. Shkalla e përgjegjësisë;
 - 3.1.3. Kushtet nën të cilat është shkaktuar shkelja;
 - 3.1.4. Puna dhe sjelljet mëparshme të kundërvajtësit;
 - 3.1.5. Si dhe rrethanat tjera të cilat kishin mund të ndikuar në shqiptimin e dënimit.

Neni 4 Dëgjimi i kundërvajtësit

- 4.1. Kundërvajtësi nuk mund të dënohet pa e dëgjuar atë, apo nëse nuk sjellë deklaratë me shkrim në afat prej 2 ditësh nga ftesa e Komisionit përkatës.
- 4.2. Nëse kryesi i kundërvajtjes refuzon të vijë në dëgjim për tu marrë në pyetje apo nuk dëshiron të jap deklaratë me shkrim në afatin e dhënë sipas paragrafit 1 të këtij neni, atëherë dënimi i shqiptohet në bazë dokumentacionit (provave) që janë në dispozicion.



Neni 5 Llojet e dënimeve

5.1. Për lojtarë:

- 5.1.1. Vërejtje;
- 5.1.2. Dënim me gjobë;
- 5.1.3. Ndalim i vazhdimit të garës;
- 5.1.4. Ndalim i pjesëmarrjes në gara për një afat të caktuar kohor.

5.2. Për zyrtarë dhe udhëheqës në gara:

- 5.2.1. Vërejtje;
- 5.2.2. Qortim;
- 5.2.3. Dënim me gjobë;
- 5.2.4. Largim nga garat;
- 5.2.5. Ndalimi i ushtrimit të funksionit në kohë të caktuar;
- 5.2.6. Ndalesë e përhershme e ushtrimit të funksionit.

5.3. Për udhëheqës të klubeve, shoqatave dhe udhëheqës të tjerë të asociacioneve brenda FTK-së:

- 5.3.1. Vërejtje;
- 5.3.2. Qortim;
- 5.3.3. Dënim me gjobë;
- 5.3.4. Ndalimi i ushtrimit të funksionit në kohë të caktuar;
- 5.3.5. Ndalesë e përhershme e ushtrimit të funksionit;

5.4. Për gjyqtarë:

- 5.4.1. Vërejtje;
- 5.4.2. Qortim;
- 5.4.3. Dënim me gjobë;
- 5.4.4. Largim nga garat;
- 5.4.5. Ndalimi i ushtrimit të funksionit në kohë të caktuar;
- 5.4.6. Ndalesë e përhershme e ushtrimit të funksionit;

5.5. Varësisht nga kundërvatja, Komisioni përkatës mund të shqipton një apo dy masa disiplinore.

Neni 6 Llojet e kundërvajtjeve

6.1. Sjelljet jo sportive :

- 6.1.1. Këto kundërvajtje mund të shkaktohen nga: lojtari, ekipi, udhëheqësit dhe personat zyrtarë në gara.

-
- 6.2. Si sjellje jo sportive mund të trajtohen këto veprime:
- 6.2.1. Sjellja e pahijshme,
 - 6.2.2. Gjest i pahijshëm,
 - 6.2.3. Sharje dhe thënie fyese verbale ,
 - 6.2.4. Kundërshtimet dhe grindjet,
 - 6.2.5. Mosrespektimi i vendimeve të gjyqtareve,
 - 6.2.6. Mosrespektimi i rregullave të lojës,
 - 6.2.7. Provokimi i publikut, mysafirëve të pranishëm, udhëheqësve dhe personave zyrtarë.
 - 6.2.8. Çdo sjellje e cila e prish prestigjin e garave.
- 6.3. Sulmi fizik:
- 6.3.1. Sulmi fizik në lojtarin, gjyqtarin, shikuesit, mysafirët apo udhëheqës dhe persona zyrtarë - vendas apo kundërshtarët, para, gjatë apo pas ndeshjes, trajtohet si kundërvajtje e rëndë përtë cilën shqiptohet njëri nga dënimet e parapara në Nenin 5 të kësaj Rregullore.
- 6.4. Mosardhja, mos përgjigjja në gara apo lëshimi i garave pa arsye.
- 6.4.1. Mosardhja, mos përgjigjja në gara apo lëshimi i garave pa arsye është kundërvajtje disiplinore për shkak të cilës lojtarit, i shqiptohet dënimi si në vijim:
 - 6.4.1.1. Denim me gjobë;
 - 6.4.1.2. Minusi të pikëve nga ranglista;
 - 6.4.1.3. Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat të caktuar kohor.
- 6.5. Ofendimi, sulmi verbal, shpifjet:
- 6.5.1. Ofendimi, sulmi verbal, shpifjet si dhe thëniet verbale të ngjashme të drejtuara lojtarëve (të vetë apo palës kundërshtare), personave zyrtarë, gjyqtarëve, funksionarëve, organizatorëve edhe publikut, konsiderohen kundërvajtje për të cilat shqiptohet masa disiplinore:
 - 6.5.1.1. Vërejtje;
 - 6.5.1.2. Denim me gjobë;
 - 6.5.1.3. Ndalim i vazhdimit të garave;
 - 6.5.1.4. Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në kohë të caktuar.
- 6.6. Nëse referët (gjyqtarët) dhe personat zyrtarë bëjnë kundërvajtje apo sillen në mënyrë jo sportive si vijon:
- 6.6.1. Mosardhja në garë pa paralajmërim,
 - 6.6.2. Tërheqja nga garat pa arsye apo pa paralajmërim,
 - 6.6.3. Konflikt fizik me të pranishmit (lojtarët, mysafirët, funksionarët dhe organizatorët),
 - 6.6.4. Konflikt verbal me të pranishmit (lojtarët, mysafirët, funksionarët e organizatorët),
 - 6.6.5. Sjelljes jo etike.



Neni 7 Procedura disiplinore

7.1. Inicimi i procedurës disiplinore

7.1.1. Procedura disiplinore mund të fillohet në bazë të :

- 7.1.1.1. Raportit të gjyqtarëve,
- 7.1.1.2. Raportit nga delegati (supervajzeri) i ndeshjes,
- 7.1.1.3. Fletëparaqitjes nga ndonjë person zyrtarë i ndeshjes nga klubet apo FTK.
- 7.1.1.4. Detyrës zyrtare të Komisionit përkatës të garave i cili në çfarëdo mënyre vjen në dijeni që kundërvajtja është kryer.
- 7.1.1.5. Fletëparaqitja disiplinore i dërgohet Komisionit disiplinor të FTK-së.

7.2. Fletëparaqitja disiplinore paraqitet kur ekzistojnë bazat e dyshimit se është bërë kundërvajtja.

7.2.1. Fletëparaqitja duhet të përmbajë:

- 7.2.1.1. Emrin dhe mbiemrin e personit-ave me shënimet elementare të tij-tyre
- 7.2.1.2. Kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së kundërvajtjes,
- 7.2.1.3. Të dhënat për dëmin eventual,
- 7.2.1.4. Provat,
- 7.2.1.5. Shkaqet në të cilat bazohen bazat e dyshimit se është bërë kundërvajtja,
- 7.2.1.6. Emri, mbiemri, pozita dhe nënshkrimi i parashtruesit.

7.3.1. Kryetari i komisionit disiplinor me vendim e hedh fletëparaqitjen disiplinore për arsye të:

- 7.3.1.1. mungesës së provave
- 7.3.1.2. ka të bëjë me veprimet a mosveprimet të cilat nuk janë paraparë si kundërvajtje,
- 7.3.1.3. është paraqitur pas afatit të përcaktuar me këtë rregullore,
- 7.3.1.4. për kundërvajtje të njëjtë me vendim definitiv është përfunduar procedura disiplinore.

Neni 8 Komisioni disiplinor

8.1. Komisioni disiplinor udhëheq procedurën disiplinore, konstaton përgjegjësinë disiplinore dhe shqipton masa disiplinore në shkallë të parë, të gjithë kundërvajtësve



- pavarësisht nga autorizimet që i kanë.
- 8.2. Komisioni disiplinor përbëhet prej 3 anëtarëve, të cilët i zgjedhë Bordi i FTK-së.
 - 8.3. Në rast mungese a pengese tjetër (konflikt interesi) të kryetarit apo ndonjë anëtarit të Komisionit disiplinor, Kryetari i Federatës me Vendim do ta caktoj për rastin konkret disiplinor (ad hoc) një anëtar tjetër.

Neni 9

Procedura e punës e Komisionit disiplinor

- 9.1. Komisioni disiplinor është i obliguar që Fletëparaqitjen, ta shqyrtoj dhe merr në procedurë në afat prej 15 dite, nga dita kur e ka pranuar.
- 9.2. Kryetari i Komisionit e cakton seancën degjimore të Komisionit disiplinor.
- 9.3. Ftesa për seancë ju dërgohet me shkrim apo në mënyrë elektronike:
 - 9.3.1. përfaqësuesit të fletëparaqitjes;
 - 9.3.2. kundërvajtësit kundër të cilit zhvillohet procedura disiplinore;
 - 9.3.3. përfaqësuesit të personit nëse ai ka angazhuar të tillë;
 - 9.3.4. dëshmitarit dhe ekspertit, kur është e nevojshme.
- 9.4. Thirrja kundërvajtësit duhet të dërgohet së paku 3 ditë para mbajtjes së seancës kryesore, me qëllim që kundërvajtësi të përgatit mbrojtjen.
- 9.5. Dërgimi i ftesës, vendimit dhe shkresave tjera kundërvajtësit i bëhet me fletëdorëzim direkt apo në mënyrë elektronike.
- 9.6. Kundërvajtësi patjetër duhet të dëgjohet para Komisionit disiplinor dhe duhet t'iu mundësohet mbrojtja.
- 9.7. Seanca para Komisionit disiplinor fillohet me leximin e Fletëparaqitjes.
- 9.8. Pas leximit të Fletëparaqitjes, ftohet kundërvajtësi kundër të cilit udhëhiqet procedura qete deklarohet lidhur me thëniet në fletëparaqitje dhe që të paraqesë mbrojtjen e vet.
- 9.9. Pas deklaratës së kundërvajtësit fillohet me nxjerrjen e provave lidhur me vërtetimin e fakteve.
- 9.10. Para fillimit të seancës, Udhëheqësi i procedurës, vërteton se a janë të pranishëm të gjithë personat e ftuar.
- 9.11. Nëse nuk ka ardhur kundërvajtësi kundër të cilit udhëhiqet procedura, Komisioni vendos që seanca të mbahet në mungesë të tij, apo do të shtyhet.
- 9.12. Nëse kundërvajtësi është ftuar në rregull, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar, seanca mund të mbahet në mungesë të tij.
- 9.13. Me rastin e shtyrjes së seancës, caktohet dita dhe ora e vazhdimit të saj.
- 9.14. Në séance mbahet procesverbal, procesverbalin e nënshkruan Komisioni, së paku dyanëtar të Komisionit.
- 9.15. Komisioni vendos se cilat prova do të nxjerr dhe sipas cilës rënditje.
- 9.16. Pas përfundimit të procedurës së nxjerrjes së provave, Komisioni ia jep fjalën, parashtruesit të fletëparaqitjes, mbrojtësit (nëse ka), e pastaj edhe kundërvajtësit kundër të cilit udhëhiqet procedura, që të japin fjalën përfundimtare. Palët mund të ftohen edhe ndaras.



9.17. Pas kësaj Komisioni tërhiqet në këshillim dhe votim (marrje të vendimit).

Neni 10 Vendimet

10.1. Komisioni mund të nxjerr njërin nga këto Vendime :

- 10.1.1. që të hedh poshtë rastin
- 10.1.2. që kundërvajtësi të lirohet nga përgjegjësia ;
- 10.1.3. që t'i shqiptohen masat e caktuar disiplinore.

11.1. Vendimi i Komisionit përmban:

- 11.1.1. Hyrjen, në të cilën shënohet:: Emërtimi i organit i cili e ka nxjerr Vendimin, përbërja e organit, lloji i shkeljes, data e mbajtjes së seancës;
- 11.1.2. Dispozitivin, në të cilin shënohet, ndaj kujt dhe çfarë mase disiplinore është shqiptuar; gjegjësisht se a është liruar kundërvajtësi nga përgjegjësia;
- 11.1.3. Arsytimi, në të cilin ceket faktet vendimtare në të cilat Komisioni është bazuar që kundërvajtësin ta liroi nga përgjegjësia apo ta shpalli përgjegjës;
- 11.1.4. Këshillën juridike, në të cilën shënohet emërtimi i organit të shkallës së dytë i cilivendos për Ankesën si dhe afati i kundërshtimit.
- 11.1.5. Kryetari apo anëtarët e Komisionit Disiplinor nuk mund të hyn në përbërje të Komisionit

- 11.1.6. Nëse është palë e dëmtuar me shkeljen e detyrave të punës ;
- 11.1.7. Nëse me kundërvajtësin, mbrojtësin e tij janë në marrëdhënie të afërt familjare .

Neni 12 Organi i shkallës së dytë - Komisioni i ankesave

- 12.1. Kundër Vendimit të Komisionit disiplinor, mund të parashtrohet Ankesë Bordit të FTK-së (si organ i shkallës së dytë), dhe atë përmes Komisionit disiplinor në afat prej 8 dite.
- 12.2. Kundër Vendimit të Bordit të FTK-së, kundërvajtësi mund të filloi procedurën tek Gjykata kompetente në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
- 12.3. Organi disiplinor i shkallës së dytë mund të:
 - 12.3.1. të vërtetoj Vendimin e Komisionit disiplinor ;
 - 12.3.2. të aprovoj kundërshtimin, anuloi vendimin e Komisionit disiplinor ;

12.3.3. të aprovoj kundërshtimin, ndryshoi vendimin e Komisionit disiplinor dhe të nxjerri vendim të cilin është i autorizuar ta nxjerr Komisioni disiplinor.

Neni 13

Vendimet e Komisionit të Ankesave

- 13.1. Bordi i FTK-së është i obliguar që të nxjerri Vendim sipas Ankesës në afat prej 30 dite, nga dita e pranimit të saj.
- 13.2. Nëse Bordi i FTK-së nuk nxjerr Vendim sipas Ankesës në afat prej 30 ditësh, kundërvajtësi ka të drejtë të filloi procedurën në Gjykatë.

Neni 14

Evidenca e masave disiplinore të shqyrtuara

- 14.1 Në FTK – mbahet Evidenca e masave disiplinore të shqyrtuara në bazë të vendimeve definitive mbi shqiptimin e tyre.
- 14.2 Evidenca e masave të shqyrtuara përmban:
- 14.2.1. Emrin dhe mbiemrin e personit (fizik-juridik) të cilit i është shqiptuar masa disiplinore,
 - 14.2.2. Funksioni që kryen,
 - 14.2.3. Numri dhe data e vendimit definitiv mbi masën e shqiptuar disiplinore,
 - 14.2.4. Për cilën kundërvajtje i është shqiptuar masa ,
 - 14.2.5. Cila masë i është shqiptuar,
 - 14.2.6. Datën e plotfuqishmërisë së vendimit,
 - 14.2.7. A është ushtruar ankesë në vendimin e komisionit disiplinor dhe çfarë vendimi është marrë sipas ankesës,
 - 14.2.8. A është zhvilluar kontest në instanca tjera jashtë FTK-së,
- 14.3. Evidencën mbi shqiptimin e masave disiplinore e udhëheq punonjësi i cili kryen punët profesionale për nevoja të komisionit disiplinor

Neni 15

Rishqyrtimi i vendimeve të Komisionit të Ankesave

- 15.1 Rishqyrtimi i vendimeve të përfunduara të Komisionit të Ankesave, mund të bëhet në këto raste :
- 1.1.1. Nëse kundërvajtësit me veprim të kundërligjshëm, e posaçërisht me lëshimin e dërgimit testës, nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në sEance;
 - 1.1.2. Nëse Vendimi i Komisionit të Ankesave bazohet në thënie të rrejshme të dëshmitarit apo ekspertit;
 - 1.1.3. Nëse Vendimi i Komisionit të Ankesave bazohet në dokumentacion të falsifikuar apo në të cilin është vërtetuar përmbajtje jo e vërtetë;
 - 1.1.4. Në qoftë se për të njëjtën kundërvajtje është marrë vendim i plotfuqishëm mbi



përgjegjësinë e personit (ekipit-individit) respektivisht është ekzekutuar masa disiplinore

- 1.1.5. Në qoftë se merret në dijeni për fakte të reja ose ofrohen mundësi të përdorimit të provave të reja në bazë të të cilave për kundërvajtësin do të mund të merrej vendim më i favorshëm sikur ato fakte apo prova do të ishin administruar në procedurën e mëparshme
- 1.1.6. Në qoftë se pas marrjes së vendimit njëri nga anëtarët e Komisionit të Ankesave është vërtetuar se ka patur konflikt interesi.
- 15.2. Propozimin për rishqyrtim e vendimit mund ta parashtrojnë njëra nga palët në kontest.
- 15.3. Propozimi i parashtrohet Komisionit të Ankesave në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dijeni për ekzistimin e shkaqeve, e më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Vendimit.

16. Dispozitat përfundimtare

- 16.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Bordit të FTK-së.
- 16.2 Procedura e ndryshimit të kësaj rregullore është identike me atë të aprovimit.
- 16.3 Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bënë Komisioni për Akte Normative i FTK-së.

Kryetari
Jeton Hadërgjonaj



17 Nëntor 2022



FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION

Kosova Tennis Federation
House of sports
Agim Ramadani str,
10000 Prishtina
Kosovo
T: +383 45 746 543
www.tenniskosova.com
